



SUCCESS STORY

Gratë Lidere të Kosovës Avokojnë për “Vend pranë Tryezës”

Tubimi një javor vë në pah sundimin e ligjit, barazin gjinore.



Presidentja e Kosovës Atifete Jahjaga (e dyta nga e djathta) pozon për një selfie me pjesmarrëset e konferencës.

Photo by: National Democratic Institute



Java e Grave fokusohet në identifikimin e grave lidere të së ardhmes në fusha të ndryshme, duke përzgjedhur kështu çdo vit një grup me qëllim të zhvillimit të mëtutjeshëm të shkathtësive gjatë Akademisë së Leadershipit të Grave.

Photo by: National Democratic Institute

Maj 2015 – Kur gratë zgjidhen, ato bëhen avokuese për çështje të cilat i prekin të gjithë: shërbimet më të mira shëndetsore, përkujdesja ndaj fëmijëve dhe edukimi, e të tjera. Në Kosovë, sikurse edhe në vendet tjera, gratë shpesh duhet të luftojnë për t’u dëgjuar zëri i tyre nëpër organizata të cilat dominohen nga meshkujt, ku kontributi i tyre mund të hedhet poshtë duke u parë thjeshtë si plotësim i një kuote.

Megjithëse Kosova udhëheqet nga një presidente grua, gratë kosovare vazhdojnë të përballen me disavantazhe ekonomike, politike dhe shoqërore. Në politikë, përfaqësimi i tyre shihet më tepër si një kërkesë që u imponohet partive politike se sa një përfitim. Kjo shpesh dekurajon gratë nga kandidimi për poste.

Në vitin 2015, për të katërtin vit me radhë, USAID-i hyri në partneritet me Institutin Demokratik Kombëtar (NDI) për të organizuar “Javën e Grave,” një tubim ky i cili zgjatë për një javë të tërë, duke mbledhur gratë kosovare lidere të mendimit në fushën e politikës, biznesit, dhe mediave, dhe mbahet çdo vit në muajin mars.

“Kur flasim për barazinë gjinore në cilëndo shoqëri, një gjë është e qartë: ajo nuk mund të arrihet pa një grup të organizuar, aktiv, dhe të zëshëm, të grave lidere të fuqizuara të cilat avokojnë për vend pranë tryezës,” pat thënë ambasadorja e Sh.B.A.-ve Tracey Ann Jacobson në fjalën e saj të hapjes për konferencën e vitit 2014.

Në vitet e fundit, diskutimet janë përqëndruar tek gratë në politikë dhe qeveri, për shkak të afërsisë kohore të zgjedhjeve lokale dhe nacionale. Këtë vit, konferenca kryesisht trajtoi ndikimin dhe kontributin e grave në sundimin e ligjit në Kosovë. Konferenca mbledhi gra lidere nga të gjitha fushat e jetës shoqërore në Kosovë, duke vu në fokus të veçantë nevojat e grave me aftësi të kufizuara.

Maj 2015

“Isha e lumtur kur pashë se këtu kishte edhe gra të tjera me aftësi të kufizuara,” tha aktivistja politike Xhevrie Peci. “Mundësia që na u dha jo vetëm për t’i sjellur preokupimet tona në tryezë por edhe për t’i diskutuar brengat e përbashkëta si gra, ishte një ndihmesë e madhe.”

“Kjo javë u jep grave një shtytje për të ecur përpara në fushat e tyre të zgjedhura,” shtoi ekspertja e raporteve ndëretnike Gordana Lazovic.

Pas Javës së Grave, një grup i përzgjedhur prej 30 grave vazhdoi më tutje duke vijuar trajnimin e avancuar nga zhvillimi i politikave, komunikimi, të folurit publik, avokimi, dhe mediat e reja, në kuadër të Akademisë së Leadershipit të Grave, që mbahet çdo vit.

Të diplomuarit e mëparshëm të Akademisë kanë arritur që të bëjnë ndryshime të vërteta. Një grup nga viti 2012 avokoi me sukses që qyteti i Ferizajt të sigurojë përkujdesje ndaj fëmijëve gratis për fëmijët e nënave vetëushqyese. Komisioni i BE-së gjithashtu shtoi të drejtat e nënave vetëushqyese si një objektivi të agjendës së tij të avokimit dhe, si rezultat, dy OJQ kosovare përfituan grante për të zhvilluar hulumtime në këtë drejtim.